



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
MINISTRI

Nr. 3226 Prot.

Tiranë, më 10.08 2010

URDHËR

Nr. 408, datë 10.08 2010

PËR
LIRIM DHE EMËRIM NË DETYRË

Mbështetur në Nenin 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në Vendimin e KM nr. 173, datë 07.03.2003 "Për emërimin, lirim ose shkarkimin nga detyra e drejtuesve të institucioneve në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose të Ministrit", në Vendimin e KM nr. 478, datë 18.07.2007 "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve të disa institucioneve, në varësi të disa ministrive të linjës", në Urdhrin e Kryeministrit nr. 65, datë 23.05.2008 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë së Akreditimit të Arsimit të Lartë", (i ndryshuar), në VKM nr. 424, datë 02.06.2010 "Për miratimin e Rregullores për sistemin e akreditimit, organizimin dhe veprimtarinë e institucioneve të sigurimit të jashtëm të cilësisë", në urdhrin nr. 361, datë 08.07.2010, të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës "Për formimin e komisionit të vlerësimit të kandidatëve që kanë aplikuar për postin e drejtorit të Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë", si dhe në rezultatet e Komisionit të Vlerësimit të kandidatëve që morën pjesë në konkurrim,

URDHËROJ:

1. Znj. Dhurata BOZO, të lirohet nga detyra e drejtorit të Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë, në kuadër të riorganizimit të këtij institucioni.
2. Marrëdhëniet financiare, përfshirë dhe dorëzimin e detyrës, t'i ndërpriten brenda datës 15.08.2010.
3. Z. Avni MESHË, në bazë të rezultateve të konkurrimit, emërohet drejtor i Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë.
4. Marrëdhëniet financiare në detyrën e re z. MESHË t'i fillojnë nga data 10.08.2010.
5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Programeve të Zhvillimit në MASH.

MYQEREM TAJAJ


MINISTËR

